

## **Elona Bano – Drejtor Kabineti**

Mban pozicionin e Drejtorit të Kabinetit të Ministrisë së Drejtësisë që prej muajit tetor 2021. Prej 14 vitesh ushtron profesionin e pedagoges me kohë të plotë në fushën e së drejtës. Në periudhën nëntor 2018- janar 2020 ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Diasporës (janar-prill 2020). Në vitet 2013-2014 në kuadër të programit LEAD Albania të financuar nga Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim ka mbajtur pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Insitucionit të Presidentit të Republikës. Është diplomuar juriste pranë Universitetit “Ovidius” në Konstanca, Rumani në 2002. Ka vijuar studimet master i shkencave për të drejtën ndërkombëtare publike në Universitetin “Miqësia e Popujve”, në Moskë dhe prej vitit 2017 mban titullin Doktor i Shkencave juridike nga Fakulteti i Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Gjatë karrierës së saj znj. Bano ka kontribuar në një sërë projektesh në fushën e së drejtës dhe ka qenë pjesë e Sekretariatit teknik pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi pranë Kuvendit në periudhën janar 2015- korrik 2016. Ka kryer një sërë botimesh dhe artikujsh shkencorë si dhe trajnime në fushën e drejtësisë penale, të drejtave të njeriut, ndërmejtësimit dhe arbitrazhit. Zotëron gjuhët: angleze, italiane, rumune dhe ruse.

***Fusha e angazhimit:*** Politikat në mbrojtje të dinjitetit, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe parandalimi i shkeljeve të ligjit; Axhenda e Integritimit Evropian dhe strukturat e tjera ndërkombëtare; Antikorrupsioni.